REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE

SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 21670/3 *prot.* *Lezhë, më:* 05-11-2026

NJOFTIM

"PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE/KULLOSORE NË PRONËSI TË BASHKISË DHE SIPËRFAQES PYJORE NË PRONËSI PRIVATE, PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR TË SHFRYTËZIMIT TË GURIT GËLQEROR, NË OBJEKTIN BALLDRE, NGA SHOQËRIA "LEZHA KONSTRUKSION" SH.P.K.

Bashkia Lezhë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqëverisjen vendore", në ligjin Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, në VKM-në 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", në ligjin 57/2020 "Për Pyjet", si dhe në Projekt Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Lezhë nr 21670 prot, datë 05.11.2026 "Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të bashkisë, për kryerjen e aktivitetit minerar në objektin Balldre, nga shoqëria LEZHA KONSTRUKSION sh.p.k", organizon dëgjesën publike për informimin e komunitetit dhe grupeve të interesit, lidhur me ndryshimin e kategorisë së përdorimit të territorit, për sipërfaqen pyjore të kërkuar nga shoqëria LEZHA KONSTRUKSION sh.p.k.

Në vijim të proçesit të konsultimit me publikun, ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjesën publike, ditën e marte, **datë 15.12.2026, ora 11:00,** në sallën e Bibliotekës "Gjergj Fishta" Lezhë.

Gjatë takimit të dëgjesës publike do bëhet prezantimi i dokumentacionit për kërkesën për heqje nga fondi pyjor kombëtar të shoqërisë **LEZHA KONSTRUKSION** sh.p.k.

Ju mirëpresim për të ndarë mendimet tuaja!

K R Y E T A R I

Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË